

Këshilla për pacientët dhe shërbimi ndërlidhës (Patient Advice and Liaison Service-PALS)

Nëse keni një kompliment, ankesë ose shqetësim, ju lutemi kontaktoni ekipin tonë PALS në numrin 020 7288 5551 ose në adresën whh-tr.whitthealthPALS@nhs.net

Nëse keni nevojë për një kopje të kësaj fletëpalosje me shkronja të mëdha, audio ose të përkthyer, ju lutemi na kontaktoni në numrin 020 7288 3182. Do të bëjmë më të mirën tonë për të plotësuar nevojat tuaja.

[Twitter.com/WhitHealth](https://twitter.com/WhitHealth)
[Facebook.com/WhittingtonHealth](https://facebook.com/WhittingtonHealth)

Whittington Health NHS Trust
Magdala Avenue
London
N19 5NF
Phone: 020 7272 3070
www.whittington.nhs.uk

Date published: 09/11/20
Review date: 24/09/2021
Ref: GEN/IG/HWUYPI/02-Alb

© Whittington Health
Please recycle



Si e Përdorim Informacionin Tuaj Personal

(How We Use Your Personal Information-
Albanian)

Kjo fletëpalosje shërben për të shpjeguar:

- Përse mbledhim informacion mbi ju dhe si përdoret ai
- Si e ruajmë informacionin tuaj personal në mënyrë konfidenciale
- Të drejtat tuaja për të parë të dhënat tuaja



Siguria e Informacionit

Konfidencialiteti ndikon tek të gjithë. Whittington Health mbledh, ruan dhe përdor sasi të mëdha të të dhënave personale çdo ditë, të tilla si të dhëna mjekësore, të dhëna të personelit dhe informacione të kompjuterizuara. Këto të dhëna përdoren nga shumë njerëz gjatë punës së tyre.

Ne e marrim shumë seriozisht detyrën tonë për të mbrojtur informacionin tuaj personal dhe konfidencialitetin dhe jemi të përkushtuar të sigurojmë që të dhënat tuaja të përdoren në mënyrë të përshtatshme dhe të ligjshme, duke marrë të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale për të cilat ne jemi përgjegjës, qofshin të kompjuterizuara ose në letër. Në nivelin e Bordit të Trust-it, ne kemi caktuar një Përgjegjës të Lartë për Rrezikun ndaj Informacionit, i cili është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha asetëve të informacionit dhe çdo rreziku dhe ngjarje që kanë lidhje me to dhe një Kujdestar Caldicott, i cili është përgjegjës për menaxhimin e informacionit për pacientin dhe konfidencialitetin e pacientit.

Pse Mbledhim Informacion Për Ju

Mjekët, infermierët dhe ekipi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor që kujdesen për ju mbajnë shënime për shëndetin, trajtimin dhe kujdesin që merrni nga NHS. Këto të dhëna na ndihmojnë që të sigurohemi që ju të merrni kujdesin më të mirë të mundshëm. Ato mund të shënohen në regjistra ose të mbahen në mënyrë elektronike. Këto të dhëna mund të përfshijnë:

- Të dhëna bazë rreth jush, të tilla si emri, adresa, data e lindjes, të afërmit, etj.
- Kontakti që kemi pasur me ju siç janë takimet ose vizitat në klinikë.
- Shënime dhe raporte në lidhje me shëndetin, trajtimin dhe kujdesin tuaj.
- Rezultatet e radiografisë, skanerit dhe testeve laboratorike.
- Informacion i rëndësishëm nga njerëzit që kujdesen për ju dhe ju njohin mirë si profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe të afërmit.

Auditimi Klinik

Të dhënat e nivelit të pacientit mund të përdoren për qëllime të auditimit klinik. Të gjitha të dhënat e përdorura për këtë qëllim janë plotësisht anonime. Të dhënat e auditimit klinik ndihmojnë në përmirësimin e nivelit të kujdesit shëndetësor që ofrohet në të gjithë shërbimet shëndetësore të Whittington.

Kontrolluesi i të Dhënave

Kontrolluesi i të Dhënave i cili është përgjegjës për mbajtjen e informacionit tuaj konfidencial:

Whittington Health
Whittington Hospital
Level 5
Highgate Wing
London
N19 5NF

Njoftim

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2018, kërkon që organizatat të dorëzojnë një njoftim tek Komisioneri i Informacionit për të përshkruar qëllimet për të cilat ata përpunojnë informacionin personal. Këto detaje janë në dispozicion të publikut nga:

Information Commissioner's Office
Wycliffe House
Water Lane
Wilmslow
Cheshire
SK9 5AF
Numri i Telefonit: 0303 123 1113
Adresa e internetit: www.ico.org.uk

Ligji për të Drejtën e Informimit 2000

Nëse dëshironi të kërkonin ndonjë informacion në lidhje me organizatën, i cili nuk është informacion personal, ju lutemi na shkruani ose dërgoni email në adresën foi.whitthealth@nhs.net

Si Mund të Keni Akses tek të Dhënat Tuaja

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2018 ju jep të drejtë të keni akses tek informacionet që mbajmë për ju në të dhënat tona:

- Kërkesa juaj duhet të bëhet me shkrim duke përdorur formularin tonë të aplikimit në internet.
- Kur është e mundur, ne do të përpiqemi t'ju dërgojmë të dhëna në format elektronik.
- Ne jemi të detyruar t'ju përgjigjemi brenda 1 muaji.
- Ju duhet të paraqisni një ID të vlefshme [p.sh. pasaportë ose leje për drejtimin e automjetit.] në mënyrë që identiteti juaj të mund të verifikohet dhe të regjistrohen të dhënat tuaja.
- Nëse mendoni se ndonjë informacion nuk është i plotë ose i pasaktë, atëherë ju lutemi na bëni me dije.

Programi Kombëtar për Përfundimin e të Dhënave

Ju keni të drejtë që të kundërshtoni që të dhënat tuaja të përdoren për kërkimin, planifikimin dhe drejtimin e NHS nëpërmjet Programit Kombëtar për Përfundimin e të Dhënave si dhe "të drejtën tuaj për të kundërshtuar" sipas nenit 21 të GDPR/DPA 18.

Më shumë detaje mbi mbledhjen e të dhënave mund të gjenden në faqen e internetit të NHS Digital <https://digital.nhs.uk/about-nhs-digital/our-work/keeping-patient-data-safe/how-we-look-after-your-health-and-care-information/your-information-choices/opting-out-of-sharing-your-confidential-patient-information>

Është e rëndësishme që të dhënat tuaja të jenë të sakta dhe të përditësuara. Gjithmonë kontrolloni nëse të dhënat tuaja personale janë të sakta kur na vizitoni dhe ju lutemi na njoftoni për çdo ndryshim sa më shpejt që të jetë e mundur.

Si Përdoren të Dhënat Tuaja Personale

Të dhënat tuaja përdoren për të drejtuar, menaxhuar dhe ofruar kujdesin që merrni për të garantuar që:

- Mjekët, infermierët dhe profesionistët e tjerë të kujdesit shëndetësor të përfshirë në kujdesin tuaj kanë informacion të saktë dhe të përditësuar për të vlerësuar shëndetin tuaj dhe për të vendosur për kujdesin më të përshtatshëm që duhet të merrni.
- Profesionistët e kujdesit shëndetësor kanë informacionin që u nevojitet për të qenë në gjendje të vlerësojnë dhe përmirësojnë cilësinë dhe llojin e kujdesit që ju merrni.
- Shqetësimet tuaja mund të hetohen siç duhet nëse paraqitet një ankesë.
- Informacioni i duhur është i disponueshëm nëse vizitoheni tek një mjek tjetër, ose referoheni tek një specialist ose një pjese tjetër të NHS.

Garantimi i Regjistrimit të të dhënave të Kujdesit Shëndetësor të NHS-së

Garantimi i Regjistrimit të të dhënave të Kujdesit Shëndetësor është angazhimi ynë që ne do t'i përdorim të dhënat tuaja në atë mënyrë ku respektohen të drejtat tuaja dhe promovohet shëndeti dhe mirëqenia juaj.

Kopje të dokumentit të plotë mund të merren nga www.nhscarerecords.nhs.uk/security

Me Kë e Ndajmë Informacionin Personal

Të gjithë ata që punojnë brenda NHS janë të detyruar me ligj që të mbajnë konfidencial informacionin rreth jush. Në mënyrë të ngjashme, kushdo që merr informacion nga ne është i detyruar me ligj ta mbajë atë konfidenciale.

Ne do të ndajmë informacionin me organizatat partnere kryesore si më poshtë:

- Trust-et e tjera të NHS dhe spitalet që janë të përfshirë ndaj kujdesin për ju.
- Autoriteti vendor dhe kujdesi social
- Mjekët e Përgjithshëm [Mjekët e Përgjithshëm].
- Shërbimet e Ambulancës.

Ju mund të merrni kujdes shëndetësor nga njerëz të tjerë përveç NHS-së, për shembull nga shërbimet e Kujdesit Social. Ne mund të duhet të ndajmë disa informacione rreth jush me ta në mënyrë që të gjithë të mund të punojmë së bashku në të mirën tuaj nëse ata kanë vërtetë nevojë për të ose kemi lejen tuaj. Prandaj, ne gjithashtu mund të ndajmë informacionin tuaj, në përputhje me një marrëveshje të rreptë për mënyrën se si do të përdoret, me:

- Shërbimet e Kujdesit Social.
- Shërbimet e Edukimit.
- Autoritetet Vendore.
- Ofruesit vullnetarë dhe të sektorit privat që punojnë me NHS.

Ne nuk do t'ia zbulojmë informacionin tuaj asnjë pale të tretë tjetër pa lejen tuaj, përveç rastit kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme, si për shembull kur shëndeti dhe siguria e të tjerëve është në rrezik ose në rast se ligji kërkon që ne ta japim këtë informacion.

Zbulimi i Informacionit

Ju mund të kufizoni se si dhe me kë e ndajmë informacionin personal të regjistruar në të dhënat e tua që ju identifikojnë. Kjo duhet të shënohet në mënyrë të qartë në të dhënat tuaja në mënyrë që të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe personeli që merret me trajtimin tuaj dhe janë të përfshirë me ju të jenë të njohur me vendimin tuaj. Në rast se zgjidhni këtë opsion, mund të jetë më e vështirë ose të mos mundet t'ju ofrohet trajtimi ose kujdesi. Ju gjithashtu mund të ndryshoni mendje në çdo kohë në lidhje me vendimin e zbulimit të informacionit.

Si Përdoret Informacioni Juaj Personal për Të Përmirësuar NHS

Informacioni juaj do të përdoret gjithashtu për të na ndihmuar të menaxhojmë NHS dhe për të mbrojtur shëndetin e publikut, duke u përdorur për:

- Kontrollin e kujdesit që ne ofrojmë për të siguruar që ai është i standardit dhe cilësisë më të lartë.
- T'u siguruar që shërbimet tona mund të plotësojnë nevojat e pacientit në të ardhmen.
- Të hetuar në lidhje me pyetjet, ankesat dhe pretendimet ligjore të pacientit.
- T'u siguruar që spitali merr pagesa për kujdesin që merrni.
- Të përgatitur statistika në lidhje me kryerjen e shërbimit nga NHS.
- Të kontrolluar llogaritë dhe shërbimet e NHS.
- Të ndërmarrë kërkimin dhe zhvillimin shëndetësor [me pëlqimin tuaj dhe ju mund të zgjidhni nëse doni të përfshiheni apo jo].
- Të ndihmuar në trajnimin dhe edukimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor [me pëlqimin tuaj dhe ju mund të zgjidhni nëse doni të përfshiheni apo jo].